

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	U dënua me 25 vite burg nga Dhomat e Specializuara, reagon për herë të parë Hashim Thaçi! Thirrje qytetarëve të Kosovës: Ruani qetësinë
ADRESA	https://newsbomb.al/rajon/u-denua-me-25-vite-burg-nga-dhomat-e-specializuara-reagon-per-here-te-pare-i401475
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:58:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	eb661e81eff9ddd42ffdbe9f09b497b15f2e9a6afd7120a56cd4a931c3cc3733
TEKSTI	7b15cbf1e78fd86289f7bac8628d8ce5848e0fe1161aea78c45f4caf7c3b7e8a
PAMJA	0b8b3b15f606a65550a407cf0cca430352b4d80e82f95a1394f7d4e25f857c59

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0efe91e8b96b4f169c7eeded3f01482d92fafd46ea26cc06df3895605d1597d8
E MËPARSHMJA	5df7166bd0552d8763411017b4b5cb83c45712aa6c4858f6a280db67cd3d5b53
RRËNJA MERKLE	a0e62f20f1566f1a6ab80e6e4e50c1c4744bc54a84695e6ceb27bc326e386c4d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0efe91e8b96b4f169c7eeded3f01482d92fafd46ea26cc06df3895605d1597d8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#) [Politikë](#) [Aktualitet](#) [Ekonomi](#) [Kulturë & Art](#) [Rajon](#) [Sport](#) [Bota](#) [Showbiz](#) [SocialBomb](#)

Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Rajoni

17 Shtator 2026, 18:53

U dënua me 25 vite burg nga Dhomat e Specializuara, reagon për herë të parë Hashim Thaçi! Thirrje qytetarëve të Kosovës: Ruani qetësinë

Shkruar nga Newsbomb



Gjykata e Hagës dënon presidentin Hashim Thaçi me 25 vite burg

Ish-drejtuari i UÇK-së dhe ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka reaguuar për herë të parë në lidhje me dënimin prej 25 vitesh që Dhomat e Specializuara të Hagës vendosën ndaj tij ditën e djeshme, teksa ka falënderuar qytetarët për mbështetjen që i kanë dhënë.

Përmes kryeavokatit të tij, Luka Misić, Thaçi iu është drejtuar me një mesazh të rëndësishëm qytetarëve të Kosovës. Ai u ka bërë thirrje që të ruajnë qetësinë pas vendimit të djeshëm.

"Hashim Thaçi dëshiron të shprehë mirënjohjen e tij të sinqertë për mbështetjen e madhe që ai, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi kanë marrë nga populli i Kosovës dhe nga faktori ndërkombëtar, si dhe u bën thirrje qytetarëve të Kosovës që të ruajnë qetësinë në përgjigje të padrejtësisë së djeshme", thuhet në reagim.

Po ashtu theksohet se avokatët e Thaçit do të apelojnë vendimin e djeshëm të gjykit, duke kërkuar anulim të vendimit dhe dënim më të ulët.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Gjyqtarët bënë kallëzim në SPAK për pagat, agjentët e BKH-së zbarkojnë në Kuvend, raportohet për sekuestrim dokumentesh



Bota

Kryeministri i Suedisë jep dorëheqjen, blloku i qendrës së majtë fiton shumicën në zgjedhje

Zbulo më shumë artikuj >

pasi sipas tyre ka pasur gabime te rendesishme ligjore dhe faktike.

"Kështu, Paneli i Gjykimit e ka shpallur publikisht z. Thaçi fajtor për një vrasje, ndërkohë që provat mbi të cilat u bazua ky përfundim i ka mbajtur të fshehura nga shqyrtimi publik. Z. Thaçi do ta mirëpriste një shqyrtim të tillë publik të provave", thuhet në deklaratë.

Luka Misetic: Hashim Thaçi dëshiron të shprehë mirënjohjen e tij të sinqertë për mbështetjen e madhe që ai, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi kanë marrë nga populli i Kosovës dhe nga faktori ndërkombëtar, si dhe u bën thirrje qytetarëve të Kosovës që të ruajnë qetësinë në përgjigje të padrejtësisë së djeshme.

Avokatët e z. Thaçi do ta apelojnë vendimin e djeshëm të gjykimit para Panelit të Apelit të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK), duke pretenduar se ka pasur gabime të rëndësishme ligjore dhe faktike që kanë cenuar drejtësinë e procesit gjyqësor.

Gjatë gjithë gjykimit, mbrojtja ka ngritur vazhdimisht shqetësime lidhur me drejtësinë procedurale, përfshirë shtrirjen e gjerë të pyetjeve të bëra drejtpërdrejt nga anëtarët e Panelit të Gjykimit, në një mënyrë që nuk krijonte përshtypjen e paanshmërisë. Mbrojtja pohon se ndërhyrjet gjyqësore e kaluan kufirin e kërimit neutral të së vërtetës, duke cenuar përshtypjen e paanshmërisë që kërkohet sipas standardeve ndërkombëtare të drejtësisë. Kjo mungesë paanshmërie tani reflektohet në vendimin e Panelit të Gjykimit.

Mbrojtja argumenton se konstatimet e Panelit të Gjykimit për fajësinë "përtej dyshimit të arsyeshëm" mbështeten në prova të pamjaftueshme dhe të pakonfirmuara. Për më tepër, dje Paneli i Gjykimit pretendoi publikisht se z. Thaçi ishte i përfshirë në vrasjen e Behajdin Allaqit, pasi më parë kishte urdhëruar të gjitha palët në çështje që të mos diskutonin për rastin e z. Allaqi në seancë publike dhe pasi kishte urdhëruar që të gjitha provat lidhur me atë rast të mbaheshin konfidenciale.

Kështu, Paneli i Gjykimit e ka shpallur publikisht z. Thaçi fajtor për një vrasje, ndërkohë që provat mbi të cilat u bazua ky përfundim i ka mbajtur të fshehura nga shqyrtimi publik. Z. Thaçi do ta mirëpriste një shqyrtim të tillë publik të provave.

Mbrojtja do t'i apelojë vendimet e Panelit të Gjykimit për shkak të shkeljes së të drejtave të tij themelore për një gjykim të drejtë, sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetutës së Kosovës. Z. Thaçi mohon kategorikisht çdo përfshirje në vrasje.

Respektimi i standardeve rigorozë të drejtësisë procedurale është thelbësor për ruajtjen e besimit të publikut te institucionet ndërkombëtare penale. Mbrojtja do të dorëzojë zyrtarisht Njoftimin e Apelit para Panelit të Apelit, me qëllim korrigjimin e këtyre gabimeve faktike, ligjore dhe procedurale.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Enjte 18:26

Rajoni në fuqi: Më shumë informata

Dimri po arron, Mitsotakis njorton ndërhyrjen në tregun e hidrokarbureve: Nafta do të shitet 1.75 euro/litri për...



Rajoni

Pasi Haga dha 81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së, Kurti pret Hamzan, diskutohet APELIMI i aktgjykimit

🕒 E Enjte 17:45



Rajoni

FOTO-LAJM/ Vendimi i Hagës nuk e lë pa shpresë familjen e Rexhep Selimit, bashkëshortja e tij krahë fëmijëve: Gjithmonë krenarë e të fortë

🕒 E Enjte 15:46



Rajoni



🕒 E Enjte 13:07 Newsbomb

"O Hashim ti ku je? Krejt Kosovën këtu e ke!" Studentët nuk heqin dorë, mbushin dhe sot Prishtinën, "në këmbë" për çlirimtarët (PAMJE-DETAJE)



Rajoni

Ministri i Arsimit italian merr zarf kërcënues me një plumb brenda, reagon Meloni: Akte frikacake nuk kanë vend në një demokraci

🕒 E Enjte 12:15



Rajoni

E TURPSHME/ "Kalbu në burg o i mjerë", politikani malazez nuk përmbahet ndaj Hashim Thaçit pas vendimit të Hagës

🕒 E Enjte 10:38



Rajoni



E Enjte 10:11

"Prita 6 vjet që babai im të vinte, por ma kthyen me eshtrat e copëtuara", rrëfimi RRËQETHËS i Arben Zeqirit për ditën kur serbët vranë 72 shqiptarë në Vushtrri



Rajoni

"Populli i ka shpallur çlirimtarët të pafajshëm" Deputetja e PDK-së: Po na dënohet pjesa më e bukur e historisë, që na bën krenarë që jemi shqiptarë

E Mërkurë 21:36



Rajoni

"Do përfundosh edhe vetë në Hagë!" Del VIDEO: 12 vite më parë Kurti paralajmëronte Thaçin për Gjykatën Speciale

E Mërkurë 21:07



E Mërkurë 20:03

Serbia nuk mjaftohet me 81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së, Vuçiç u kërkon të vetëve të mos festojnë: Nuk u morën parasysh të gjitha krimet kundër serbëve



Rajoni

81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së, Kroacia: Ky vendim se ndryshon faktin që populli i Kosovës ishte viktimë e Millosheviçit



Rajoni

"Albin, hajde poshtë", protestuesit të "nxehur" me Kurtin, qëllojnë me gurë ndërtesën e Qeverisë në Prishtinë (VIDEO)

🕒 E Mërkurë 17:03

🕒 E Mërkurë 16:26



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.